

VENDIM
Nr. 241, datë 3.8.2023

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “JOINT VENTURE 2B 1979 DHE 2T” SHPK
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR
2 mw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1964/3 prot., datë 2.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Joint Venture 2B 1979 dhe 2T’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1964 prot., datë 25.7.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën Grykë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- ERE, me *email*-in e datës 31.7.2023, ka kërkuar nga shoqëria që të depozitojë kontratën përkatëse të nënshkruar me MIE-n, në vijim të miratimit të marrë prej saj dhe/ose aktin në të cilin MIE njeh shoqërinë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. si shoqëria që do të operojë centralin fotovoltaike.

- Me *email*-in e protokolluar në ERE me nr. 1964/2 prot., datë 1.8.2023, aplikuesi ka depozituar dokumentacion plotësues, nga i cili konstatohet se në vijim të marrjes së miratimit për ndërtim të dhënë nga MIE me nr. 7234/2 prot., datë 22.11.2022, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive, “2T” dhe “2B 1979” sh.p.k. ka nënshkruar me MIE-n kontratën nr. 340 rep., nr. 1429 kol., datë 19.5.2023, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, dhe veprave ndihmëse, në zonën Grykë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga Bashkimi i Përkohshëm i shoqërive ‘2T’ sh.p.k. dhe ‘2B 1979’ sh.p.k.”.

- Nga dokumentet e depozituara në ERE nga shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., me *email*-in e datës 1.8.2023, konstatohet se dy shoqëritë e Bashkimit të Përkohshëm kanë rënë dakord për të krijuar shoqërinë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., me qëllim ndërtimin e impiantit të ri gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike (gjë që përbën dhe objektin e vetëm të veprimtarisë së saj, referuar ekstraktit historik të regjistrit tregtar të QKB-së) dhe në asnjë nga dokumentet e këtij aplikimi nuk rezulton që kësaj shoqërie t’i njihet e drejta për të operuar këtë central.

- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE lëshon licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, ndërkohë që nga vlerësimi i dokumentacionit të depozituar nga aplikuesi me *email*-in e datës 1.8.2023, konstatohet se shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. i njihet e drejta e ndërtimit dhe jo e operimit të centralit fotovoltaike, në vijim të marrjes së miratimit nga MIE për ndërtimin tij, me nr. 7234/2 prot., datë 22.11.2022.

- Në këto rrethana dhe në kuadër të mosplotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet mosfillimi i procedurës për këtë aplikim.

- Në mbështetje të parashikimeve të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijëni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Nëse aplikuesi paraqet një aplikim të ri, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijëni e vendimit të Bordit të ERE-s për mosfillimin e procedurës, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa e aplikimit do të konsiderohen të vlefshme edhe për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Joint Venture 2 B 1979 dhe 2 T” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Erjola Sadushi